

05.05.2023  
Ora 15:07

**RENDI I DITËS**

Projektvendimi “Për miratimin e Udhëzuesit të Punës për Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe Grupet e Numërimit të Votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

• **Komisioni Rregullator:**

- Ilirjana NANO Kryetar
- Arens ÇELA Anëtar
- Dritan ÇAKA Anëtar
- Helga VUKAJ Anëtar
- Muharrem ÇAKAJ Anëtar
- Stafi KQZ Y. Merkaj, M. Koja, E. Meta  
A. Tahiraj

Parti Politike: S’ka prezent

OJQ: KRIIK , prezent (vjen me vonesë)

*Znj. I. Nano:* Përshëndetje, fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme në orën 15:00. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretari i Përgjithshëm dhe zyrtarë të tjerë të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në rendin e ditës të mbledhjes kemi një çështje për shqyrtim, kemi projektvendimin “Për miratimin e udhëzuesit të punës për komisionet e zonave të administrimit zgjedhor dhe grupin e numërimit të votave për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore”. Më lejoni

Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.05.05.2023*

të pyes paraprakisht anëtarët e tjerë të Komisionit Rregullator për ndonjë çështje të mundshme jashtë rendit të ditës që dëshirojnë ta diskutojnë. Po znj. Vukaj?

**Znj. H. Vukaj:** Po, kam një çështje jashtë rendi të ditës.

**Znj. I. Nano:** Po! Në mbledhje na janë bashkuar edhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Atëherë, projektvendimi i sotëm vjen me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kështu që për të paraqitur në mënyrë të përmbledhur projektin dhe relacionin do të ftoja Sekretarin e Pwrgjithshwm, zotin Merkaj!

**Z. Y. Merkaj:** Faleminderit! Në referencë të neneve 115 dhe vijues të Kodit të Zgjedhor, të cilat përcaktojnë procesin e numërimit të votave në vendin e numërimit të votave, apo radhën e numërimit të votave për zgjedhjet e pushtetit vendor, është hartuar udhëzuesi i punës për komisionet e zonave të administrimit zgjedhor dhe grupet e numërimit të votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Ky udhëzim ka për qëllim të detajojë detyrat dhe mënyrën e funksionimit të KZAZ-së, dhe të anëtarëve të grupit të numërimit të votave gjatë procesit të numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor në zgjedhjet e qeverisjes vendore. Ky udhëzues vlen dhe është në funksion jo vetëm edhe të anëtarëve të KZAZ-së dhe të grupeve të numërimit, por edhe trajnerëve të administratës zgjedhore për zhvillimin e trajnimeve. Në udhëzim janë përcaktuar dhe parashikuar vendimet paraprake të KZAZ-së, për fillimin e procesit të numërimit të votave. Ndërsa procesi i numërimit të votave qartësohet sipas ndarjeve dhe nënpikeve, duke filluar nga veprimi që KZAZ-ja merr për fillimin e procesit të numërimit të votave, veprimet paraprake të grupit të numërimit të votave, radhën e numërimit, hapjen e kutisë së votimit me fletët e votimit, numrin e fletëve të votimit, vlerësimin e tyre,

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.05.05.2023*

vlerësimin e votës si dhe kontestimin dhe rivlerësimin e votës. Udhëzuesi sqaron rrethanat që çojnë në hapjen e kutisë së materialeve të votimit dhe veprimeve që kryen grupi i numërimit të votave me kutinë e materialeve të votimit, në rastet kur procesverbali për mbylljen e votimit nuk gjendet në kutinë e materialeve të votimit apo veprimet që kryen grupi i numërimit të votave, kur ky procesverbal gjendet në këtë kuti. Një proces tjetër i trajtuar përgjatë udhëzimit është ai që lidhet me nxjerrjen e rezultatit, të rezultateve të zgjedhjeve nga grupi i numërimit për qendrën e votimit. Gjithashtu trajtohet the plotësimi i tabelës së rezultateve dhe dërgimi i tyre në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Së fundmi në udhëzues flitet edhe për tabelën përmbledhëse të rezultateve për kryetarin e bashkisë dhe këshillin e bashkisë, si dhe sqarohet dërgimi i këtyre materialeve nga KZAZ-ja në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Bashkëlidhur keni udhëzimin si dhe projektvendimin për miratimin e tij. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zoti Merkaj. Atëherë, sikundër Sekretari i Përgjithshëm e theksoi, ky udhëzues, do t'i shërbejë në mënyrë të posaçme grupeve të numërimit të votave në vendet e numërimit të votave për organet e qeverisjes vendore dhe me miratimin e tij padyshim që administrata ka mundësi të zhvillojë trajnimet, duke e pasur edhe këtë si material. Është momenti që të falënderoj administratën e KQZ-së në fakt për një punë jo të vogël që ka bërë dhe është duke bërë. Po flas lidhur me hartimin e projektakteve, që ne si Rregullator kemi miratuar para zhvillimit të zgjedhjeve, padyshim që ka vend gjithmonë për përmirësime, por besoj që e kemi mirëkuptimin e njeri-tjetrit dhe të administratës për të vlerësuar këto procese edhe kur janë në kushtet e emergjencës. Atëherë kalojmë në diskutimin në parim të projektvendimit. Kolegë kemi diçka në parim? Jo! Kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



**Kundër: S'ka**

**Me 5 vota pro, miratohet!**

Fillojmë nen për nen apo pikë për pikë. Atëherë me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator vendosi:

- Miratimin e udhëzuesit të punës për komisionet e zonave të administrimit zgjedhor dhe grupet e numërimit të votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi. Tani, teksti që i bashkëlidhet këtij vendimi është një material voluminoz, paraprakisht kemi dakordësuar që të mos lexohen të gjitha, por të shihen sipas krerëve që kanë udhëzuesit. Atëherë fillojmë me kreun 1. Rregullat e etikës. Kolegë keni diçka për këtë kre? Po zonja Vukaj!

**Znj. H. Vukaj:** Atëherë, administrata vërtet ka draftuar rregullat e etikës dhe është bazuar fillimisht tek parimet, por nuk e gjej në simfoni me parimet që Kodi i Procedurës Administrative rendit në kushtet e një veprimtarie administrative apo të akteve administrative, ndaj do propozoja një riformatim të tyre, duke zëvendësuar parimet, siç thuhet: i “legjitimitetit” në draft, me parimin e “ligjshmërisë”, të vijojë me parimin e “objektivitetit, përgjegjshmërisë, transparencës, paanshmërisë, profesionalizmit”, më pas vazhdon fjalia siç gjendet edhe në draft, në përputhje me Kodin Zgjedhor. Po ashtu në paragrafin e fundit të Rregullave të Etikës, në faqen 1, ku ka parashikuar në këtë draft administrata të udhëhiqet që... ka parashikuar që GNV-ja, të udhëhiqet nga interesi publik e veprimtarisë së tij, do të thoja që është e cunguar nëqoftëse ne nuk do të përmendnim parimin e paanësisë. Pra, paanësia, e cila rrjedh nga parimi i ligjshmërisë duhet të paraprijë interesin publik që është interesi me i lartë. Pra GNV-ja, dhe anëtarët e grupeve të numërimit duhet të kenë parasysh që të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me parimin e paanësisë dhe me pas interesin publik. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



**Znj. I. Nano:** Pra propozimi i znj. Vukaj është për të shtuar në fjalinë e parë, e para për të zëvendësuar legjitimitet me ligjshmëri, për të shtuar përgjegjshmëri, objektivitet, dhe në fjalinë e fundit para interesit publik të shtohet dhe parimi i paanësisë. Për kreun 1, rregullat e etikës kemi propozime të tjera? Jo. Votojmë atëherë propozimin e znj. Vukaj.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka

**Me 5 vota pro, miratohet!**

Kreu 2, rregulla në vendin e numërimit të votave. Nuk ka!

3. Radha e numërimit të votave. Jo.

Kreu 4. Llojet e votave dhe kriteret e vlerësimit të tyre. Po zoti Çaka?

**Z. D. Çaka:** Atëherë, tek llojet e votave, për ato të cilat konsiderohen të pavlefshme, në draft është cituar që konsiderohen vota të pavlefshme “fleta e votimit që nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja apo kur fletës së votimit i mungojnë dy vulat në pjesën e saj të pasme, përkatësisht vulën e KQV-së dhe ajo e kryetarit”. Atëherë duke iu referuar dispozitave të kodit dhe të gjithë akteve normative që kemi miratuar ne si Komision Rregullator, fleta e votimit e pavlefshme nuk është vetëm në rastin kur mungojnë të dy vulat, por edhe njëra prej tyre. Pra, do të propozoja që aty ku është cituar “fletës së votimi i mungojnë dy vulat” të shtohet “një ose dy vulat që ndodhen në pjesën e saj të pasme”, pra që edhe për grupet e numërimit të jetë e specifikuar që qoftë edhe mungesa një vule e bën fletën e votimit të pavlefshme dhe jo të dyja. Për kreun 4, keni propozime të tjera? Jo. Votojmë propozimin e zotit Çaka.

**Kush është dakord?**

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.05.05.2023*

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka

**Me 5 vota pro, miratohet!**

Kreu 5. Veprime paraprake të KZAZ-së. Kolegë kemi diçka? Jo.

Kreu 6. Procesi i numërimit të votave. Unë shoh nja dy gjëra thjesht gjuhësore, gramatikore për shembull shoh që në fjalinë e parë është 2 herë KZAZ-ja. Pra, të hiqet kjo gjatë zbardhjes dhe te pika 3, hapja e kutisë së votimit, paragrafi 3, numëruesi i parë dhe anëtarët e grupeve të numërimit , te paragrafi 4, nëse procesverbali... pra këto nuk janë për të kaluar për votim por gjatë zbardhjes...

Diçka tjetër kolegë tek kreun 6? Pra, as për të votuar këto nuk janë propozime, korigjime të vogla.

Kreu 7. Hapja e kutisë së materialeve të votimit. Në fakt tek pika 4, e këtij kreu në faqen 12, Administrimi i votave të hedhura gabim dhe numërimi i tyre, thjesht doja të konsultoja diçka në faqen 12.

**Z. D. Çaka:** Është kreu tjetër.

**Znj. I. Nano:** Ju kërkoi ndjesë atëherë. Te kreu 7, nuk kemi gjë. Kalojmë te kreu 8, Te kreu 8, kam diçka po pyes administratën, pika 4. Administrimi i votave të hedhura gabim dhe numërimi i tyre, paragrafi 2, “Kur GNV përfundon së numëruari kutinë e fundit të saj, numëruesi i parë plotëson procesverbalin e konstatimit për votat e hedhura gabim”. Në fakt unë e konsultova paraprakisht edhe me vendim që kemi miratuar disa ditë më herët dhe do të mendoja kolegë që të bënim një ndryshim për të saktësuar “çdo GNV”, kur “çdo GNV përfundon”, sepse është një proces që mbyllet me një procesverbal konstatimi, por brenda çdo GNV-je sepse deri në 10 kuti mund të numërojë një GNV pastaj vjen grupi tjetër zëvendësues. Që do të thotë mund të dalin vota të hedhura gabim në 10 kutitë e para që i numëron një grup, por mund të dalin vota të hedhura

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.05.05.2023*

gabim edhe në 10 kutitë e dyta që i numëron grupi tjetër. Në fakt në vendim e kishim numëruesi i parë...

**Z. M. Çakaj:** Ose nëse ka diçka administrata që mund të sqarojë, le të na e sqarojë. Në respekt të Kodit çdo GNV është një formacion administrimi më vete, që funksionon si njësi më vete apo jo? Atëherë duhet vendosur në numrin shumës çdo GNV.

**Z. E. Meta:** Votat e hedhura gabim e reflekton dhe tek tabela e qendrës së votimit kështu që i numëron grupi i numërimit. Ndërsa informacioni hidhet te procesverbali i konstatimit që është i posaçëm dhe i mban vetë KZAZ-ja, në rastin konkret.

**Znj. I. Nano:** Po, që do të thotë? Një grup numërimi mbarojë kutinë e 10-të, të vetën...

**Z. E. Meta.:** Është procesverbali i konstatimit që përmban KZAZ-ja.

**Znj. I. Nano:** Numëruesi i parë plotëson procesverbalin e konstatimit.

**Z. M. Çakaj:** Paragrafi 2, në pikën 4, faqen 12, paragrafi 2 “Kur GNV përfundon së numëruari kutinë e fundit të saj...” sjellim në vëmendje të administratës! Më ndiqni, ju lutem! Sjellim në vëmendje të administratës se në një ZAZ ka disa grupe numërimi, mund të këtë... zakonisht janë 5 dhe çdo grup numërimi ka tavolinën e tij të numërimit, ka përbërjen e tij dhe funksionon në mënyrë të pavarur nga grupet e tjera. Që do të thotë potencialisht ose hipotekisht çdo grup numërimi mund të rasisë, meqenëse bëhet fjalë për zgjedhjet vendore. Pra kemi

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.05.05.2023*

dy fletë votimi fletët për kryetarin e bashkisë dhe fletët për këshillin bashkiak çdo grup numërimi mund të konstatojë, mund të hasi gjatë procesit të numërimit fletë të hedhura gabim. Dhe në rastin konkret mban proces verbal çdo grup numërimi mban “procesverbal konstatimi” për këto dhe i hedh të kutia e fletëve të votimit që e ka ZAZ-ja. Pra qëllimi i ndryshimit të këtij parashikimi është kur GNV-të, pasi bëhet fjalë që një ZAZ ka disa GNV, të cilat veprojnë në mënyrë individuale të pavarura nga njëra-tjetra. Pra, numri shumë besoj e përmbush...

**Znj. I. Nano:** Ose çdo GNV. Do të sjell në vëmendje formulimin të cilin ne e kemi miratuar në vendimin e para disa ditëve, për organizimin e punës në vendet e numërimit të votave. Pikërisht te kreu i administrimit të votave të hedhura gabim jemi shprehur, “Numëruesi i parë në përfundim të kutisë së fundit që numëron GNV-ja përkatëse, plotëson procesverbalin e konstatimit për votat e hedhura gabim”, pra, nënkupton këtë proces të ndarë që sapo tha zoti Çakaj. Pra, çdo GNV pasi ka mbaruar kutitë e veta, plotëson një procesverbal konstatimi për votat e hedhura gabim, po kështu GNV-ja tjetër, po kështu GNV-ja tjetër. Atëherë unë propozoj “çdo GNV, kur përfundon së numëruari kutinë e fundit të saj, numëruesi i parë plotëson procesverbalin...” dhe vijon fjalia. Atëherë kolegë lidhur me..? Erjon, Tea, kenë diçka? Pra qartësohet besoj tani. Për kreun 8 kemi diçka tjetër? Jo, votojmë atëherë këtë propozim.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundër:*** S’ka

***Me 5 vota pro, miratohet!***

Kreu 9. Nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultateve nga KZAZ-ja. Ka diçka?  
Jo!

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.05.05.2023*

Kreu 10. Dërgimi i materialeve zgjedhore në KZQ. Kemi lidhur me kreun 10? Jo, nuk kemi. Atëherë do të me duhet të rikthehem te projektvendimi, se ky ishte teksti bashkëlidhur, të votojmë pikën 1.

Pra Komisioni Rregullator, vendosi:

1. Miratimin e Udhëzuesit të Punës për Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe Grupet e Numërimit të Votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka***

***Me 5 vota pro, miratohet!***

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka***

***Me 5 vota pro, miratohet!***

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka***

***Me 5 vota pro, miratohet!***

Kalojmë ne votimin në tërësi të projektvendimit, pasi e kemi votuar atë në parim dhe nen për nen. Edhe një herë kolegë.

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka***

***Me 5 vota pro, miratohet!***

Në rendin e ditës nuk kishim çështje tjetër, ka kërkuar zonja Vukaj fjalën për çështje jashtë rendit të ditës.

***Znj. H. Vukaj:*** Faleminderit! Atëherë të nderuar kolegë, të nderuar ju stafi prezent i administratës. Me lejoni që të cek 2 probleme tashmë fenomene të këtyre ditëve. Por, përpara se të kaloj te problemet do të doja të bëja një parantezë të shkurtër, të cilat siç e dini, ne kemi pasur një aktivitet goxha voluminoz, intensiv nga ju, nga ne, dhe të cilit po i vjen pothuajse fundi. Po afrohem drejt ditës së zgjedhjeve. Jemi përpjekur që në të gjithë këtë periudhë të garantojmë dhe të ruajmë strikt parimet dhe principet e ruajtjes së votës se libre, garantimit të votimit dhe njëkohësisht dhënies së mundësisë së barabartë të kandidatëve që garojnë këtë here. Me lind pyetja ose retorika e natyrshme, a i përgjigjet ky patos i yni, dhe ndjeshmëria jonë, të njëjtës notë që kemi pasur ne. A i gjejmë ne nga institucionet ligjzbatuese apo institucione të tjera në terren, të cilat në funksion dhe ruajtjes së parimeve demokratike duhet të ishin po kaq të përgjegjshme. Përpara se të konkludojë apo të kem shprehimisht përpara jush notat e mia pesimiste, në përfundim do t'i referohem vetëm medieve dhe informacioneve që mua personalisht më kanë ardhur në këtë periudhë nga Vermoshi në Konispol. Por me çfarë kanë të bëjnë këto informacione? Përveç të tjerave, me një fenomen, i cili po na shkatërron demokracinë, po na shkatërron votën e lirë dhe të drejtën për të votuar lirisht. Ky fenomen ka të bëjë me shitblerjen e votës. Vërtet ne vëmë në ato tabelat elektronike, apo pankarta apo reklamojmë se shitblerja e votës është krim zgjedhor etj... Por me sa duket nuk ndalen, ata që janë të prirur ta bëjnë këtë

***Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI***



deri në fund e kam fjalën këtu për drejtuesit e njësive administrative në të gjithë Republikës, të cilët serbes janë angazhuar më shumë se kurrë për shitblerjen e votës duke vënë në lëvizje të gjithë mekanizmat dhe punonjësit e administratës përkatëse vendore të shantazhojnë t'u marrin karta, të blejnë vota, të shpërndajnë para, të shpërndajnë ndihma, ditën, natën dhe pa ju dridhur qerpiku. Kjo të nderuar është shumë e rëndë! Këto janë ditët e fundit apo java e fundit dhe ne e dimë që java e fundit do të jetë edhe më dinamike për këta elementë në terren të cilët e kanë ndarë trurin që do t'i shkojnë deri në fund shitblerjes së votës apo ezaurimit të këtyre krimeve zgjedhore, se me sa duket kanë garancinë që nuk i prek asgjë. Nga informacionet gjithashtu vjen, që jo vetëm kanë kurajën këta punonjës, për të cilën i bëj thirrje prezencës së OSBE/ODHIR-it që mjaftojnë të shkojnë në institucionet publike vendore apo qendrore dhe të verifikojë prezencën e specialisteve apo punonjësve të administratës gjatë ditës. Do shohin që detyrën e kanë braktisur masivisht në shërbim të kësaj fushate. Jo vetëm kaq, por njësitë dhe drejtuesit e njësive administrative vendore kanë madje përkrahjen edhe të eksponentëve me precedent penal apo grupeve të strukturuar, të cilët janë angazhuar paralelisht me ta dhe përsëri nuk u dridhet as syri e qerpiku. Në këtë kuadër i bëj thirrje zotit Rrumbullaku, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit të angazhohet maksimalisht për dhënien fund të këtij fenomeni. Gjatë kësaj periudhe, unë personalisht ashtu si gjithë shqiptarët nuk kemi parë kurrë në asnjë moment në media të shkruar dhe vizive që kemi parandalimin, ndalimin apo goditje të individëve apo grupeve të cilët ditën për diell blejnë shesin dhe marrin karta identiteti. Mjafton t'i referohesh një qendre banimi këtu në Tiranë dhe njihet me gisht personi i cili merr karta identiteti dhe nuk e ka fare problem që ta bëjë këtë gjatë ditës edhe në prezencë të personave të tjerë. Kështu që një inspektor i përgjegjshëm mund ta kishte bërë më së miri detyrën e tij nëqoftëse do të kishte respektuar ligjin. Por kjo apati ndoshta ka një emër, ndoshta s'po i vë emër, por le të merret në konsideratë nga zoti Rrumbullaku për ditët që kanë mbetur, për ta

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



goditur këtë fenomen dhe në të njëjtën kohë për të survejuar të gjithë grupet kriminale të cilat janë angazhuar në këtë periudhë. Gjithashtu zoti Rrumbullaku, ju bëj thirrje publike me autoritetin që ligji më ka dhënë për të garantuar përmes akteve dhe vullnetit të shprehur përmes votës sime, të votës së qytetarëve shqiptarë. Ti, ju më saktë duhet t'i përgjigjeni kësaj periudhe me forca të shtuara policie dhe të demonstroi që respektoni ligjin dhe jeni në paanësi sot dhe garant i sigurisë publike, i votës së lirë dhe në të njëjtën kohë i përmbushjes së detyrës nga ana juaj. Gjithashtu bëj me dije po zotit Rrumbullaku, që fenomene të tilla, si e Elbasanit nuk duhet të ndodhin, prandaj duhet të merrni masa për angazhimin e strukturave tuaja të jenë maksimalisht të përgjegjshme që t'u përgjigjen të gjithave thirrjeve të çfarëdo lloj përfaqësuesi të forcave politike të cilët do të ndihen të intimiduar, të presionuar dhe do kenë situata në terren, të cilat nuk duam të agravojnë në krime zgjedhore apo marrje jetësh në njerëzve të pafajshëm. Unë kaq kisha, dhe shpresoj që zoti Rrumbullaku dhe strukturat e policisë se shtetit ta kenë këtë përgjegjshmëri. Dhe fjala ime thjesht dhe ka vetëm paralelizëm në këtë rast, por ndjeva detyrën qytetare që ta përçoja mediatikisht dhe të garantoja edhe një herë punën që kemi bërë dhe mundin e të gjithë neve. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zonja Vukaj, meqë nuk kemi çështje tjetër për të diskutuar mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

#### **Vendim nr. 24**

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*

